

## Komunikimi si Proçes!!!

**Komunikimi-** Eshtë një proçes i gjerë i cili i referohet mënyrave përmes të cilit ne përcjellim informacion në cilësinë e marrjes dhe dhënies.

Komunikimi nis kur bebja qesh/buzëqesh me prindërit, belbëzon me ta duke i parë si model.

Foshnjat zhvillojnë aftësitë e komunikimit në muajt e parë të jetës duke i përsosur më tej.

Komunikimi u mëson shprehitë sociale si: të mësuarin për të marrë rradhën, për të dëgjuar dikë, për të vendosur kontaktin me sy.

Tek fëmijët të folurit zhvillohet më ngadalë dhe vjen para gjuhës së shprehur.



## Aktivitete për të stimuluar Zhvillimin Gjuhësor nga Stafi Edukator!!!


**Edukatorja**—Eshtë person i rëndësishëm për fëmijën pas prindërve. Psikologët dhe punonjësit socialë në çerdhe ndihmojnë në ngritjen/krijimin e një marrëdhënie besimi mes tyre.

Komunikimi me fëmijët me fjalë/fjali të plota. Rëndësi merr përsëritja e termave pasi përmes saj fëmijët memorizojnë më shumë.

Biseda me fëmijët për aktivitetet në çerdhe duke i përshkruar, duke punuar me fjalë dhe figura.

Komunikimi paralel verbal-joverbal p.sh. duart, gjestet, pamjet të shoqërohen me fjalën.

Mësimi i ushqimit me lugë në çerdhe ndihmon në vendosjen në punë të muskujve të të folurit. Emërtimi i ushqimeve, përbërësve stimulon fillesat e bashkëbisedimit.



**Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve**

**Këshilla për Zhvillimin Gjuhësor tek Fëmijët 0-3 vjeç**

**Teknika Stimuluese**



Adresa: Rruga e Barrikadave.  
Nr.tel. 042222991



## Çfarë është gjuha?

Gjuha mësohet duke e dëgjuar dhe duke e folur. Ky proces zhvillohet së tepërmi kur të rriturit inkurajojnë dhe mbështetin përpjekjet e fëmijës për t'u shprehur.

Referuar studimeve janë përcaktuar disa stadi të zhvillimit gjuhësor.

**Stadi I-** Bebet qajnë gjatë lindjes.

**Stadi II—** Bebet gugasin.

**Stadi III-** Bebet belbëzojnë.

**Stadi IV-** Bebet nisin të flasin.

**Stadi V-** I foluri telegrafik—dy fjalë p.sh. Babi im.

**3-4 vjeç-**Fjalitë bëhen më komplekse dhe fëmijët përdorin kohën e shkuar.

Gjuha është e rëndësishme në vetë-rregullim, pasi fëmija përdor të folurin e tij për të kontrolluar siellien.

## Aktivite për të stimuluar Zhvillimin Gjuhësor!!!

**Flisni ngadalë** - Përpiquni të flisni me fëmijën ngadalë, duke shqiptuar mirë fjalët. Të folurit e shpejtë do të vështirësonte punën e tij/e saj.

**Përqendrimi tek fjala** - Kur bisedohet me bebin të vendoset theksi tek fjalët më kuptimplotë—të lidhen me rutina të ditës si p.sh “do të pimë qumështin”.

**Imitoni pas tyre** - Kur bebi bisedon duke thënë ma-ma, ba-ba, të pasohet nga ju me të njëjtat rrokje.

**Këngë me rimë**—Të përsëriten çdo ditë të njëjtat këngë.

**Flitini si një i rritur**— Përdorni fjalë të plota dhe të sakta.

**Lexoni me fëmijët** - Leximi u jep mundësi të dëgjojnë fjalë të reja



## Stili i Prindërimit në Zhvillimin e Gjuhës!!!

**Vëmendje për atë që thotë fëmija** -Shikoni nëse është në harmoni me kontekstin e saj.

**Vëmendja ndaj mënyrës sesi flet fëmija**— Mos i mëshoni gabimeve që bën.

**Krijojini mundësi fëmijës** të kuptojë se gjuha dhe komunikimi është kënaqësi.

**Korelacioni midis feedbackut pozitiv/negativ**—Të vegjlit që dëgjojnë më shpesh “jo, mos, stop” kanë aftësi më të varfra gjuhësore.

**Fjalori divers**— Përdorni fjalë dhe fjali të ndryshme të pasura me emra, mbiemra, përemra etj.

